

PSH.nr.1109/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Nuhi Paçarizi - Kryetar, Blerim Dina - Referues, Goran Milenkovic - Anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “International Security Association” SH.P.K-Prishtinë, kundër njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Sigurimi fizik i Objekteve të Komunës së Gjakovës” me nr. të prokurimit: 632-20-7505-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- “KK-Gjakovë”, më datën: 11.01.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “International Security Association” SH.P.K-Prishtinë, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sigurimi fizik i Objekteve të Komunës së Gjakovës” me nr. të prokurimit: 632-20-7505-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- “KK-Gjakovë”,

II. VËRTETOHET, njoftimi për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull “Sigurimi fizik i Objekteve të Komunës së Gjakovës” me nr. të prokurimit: 632-20-7505-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- “KK-Gjakovë”.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “International Security Association” SH.P.K-Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues “International Security Association” SH.P.K-Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 09.12.2020 me nr. 1109/20, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Sigurimi fizik i Objekteve të Komunës së Gjakovës” me nr. të prokurimit: 632-20-7505-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- “KK-Gjakovë”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 17, 27 dhe 28 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe Ligjin e Punës-03/L-212.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 18.12.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 23.12.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues sqaron si në vijim:

Pretendimi i OE: Neni 17 - Llogaritja e vlerës së parashikuar të kontratës për shërbime Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë si dhe specifikimet teknike të detyrueshme, konstaton se ky pretendim i OE “International Security Association” SH.P.K është i pabazuar, për faktin se: Operatori ekonomik “International Security Association” SH.P.K, ka llogaritur gabimisht pagën bruto (284.49 euro) për punëtor;

DËSHMI:

Në vijim e gjeni përlllogaritjen e pagës

Paga BRUTO	Kontributi nga punëtori (5%)	Kontributi nga punëdhënësi (5%)	Gjithsej Kontributi	Paga që tatohet	Gjithsej tatimi	Paga NETO
270.94	13.55	13.55	27.10	257.39	7.39	250.00

Shënim: Të ardhura të tatueshme — Kur nga paga bruto zbriten kontributet pensionale, atëherë pjesës së mbetur i referohemi si “të ardhura të tatueshme”. Pra, nga shuma e pagës bruto, fillimisht zbritet Kontributi Pensional i të punësuarit dhe më pastaj shuma e mbetur tatohet. Tatimi i pagës prej 0 - 80 = 0.00 € Tatimi i pagës prej 80 - 250 = 6.80 € Tatimi i pagës prej 250-450 = 0.59 € Gjithsej tatimi i pagës = 7.39 €. Po ashtu kjo mund të vërtetohet edhe në kalkulatorin e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), të cilin mund të gjeni në ueb faqen e ATK-së, në linkun në vijim: <http://ëëë.atk-ks.org/kalkulatori-i-pagave-nga-neto-ne-bruto/> . Po ashtu, OE ankues ka llogaritur 36 punëtorë që duhet angazhuar në këtë aktivitet të prokurimit përderisa në dosjen e tenderit (DT) dhe në njoftimin për informata shtesë ose përmirësim i gabimit (Formulari B54), nga AK, ka përcaktuar/njoftuar që numri i punëtorëve që do të angazhohen me këtë kontratë do të jetë 34 punëtorë. B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara Me këtë kontratë parashihet angazhimi i punëtorëve për sigurim fizik në objektet e Komunës së Gjakovës. Punëtorët e angazhuar me këtë kontratë do të punojnë 8 orë në ditë / 40 orë në javë (Në harmoni me ligjin e Punës LIGJI Nr. 03/L-212). Numri i punëtorëve që do të angazhohen me këtë kontratë do të jetë 34 punëtorë, me mundësi të shtimit edhe të punëtorëve të tjerë në rast nevojë (sipas kërkesës së menaxherit të Kontratës). Duke u nisur nga kjo, vërtetojmë se buxheti i planifikuar është:

Numri i punëtorëve	Paga bruto	Shuma e pagave për muaj	Afati i paraparë i kontratës	Total buxheti për punëtorët e angazhuar	Total buxheti me taksat tjera TVSH	Vlera e parashikuar e kontratës
34	270.94	9,211.96	24 muaj	221,087.04	260,882.71	267,269.20

Kalkulimet tregojnë se buxheti i planifikuar është brenda vlerës së parashikuar të kontratës nga AK. Meqenëse njoftimi për kontratë/DT ka për qëllim dhënien e një kontrate publike kornizë, AK-së i lejohej një devijim deri në 30% +/-, e cila është paraqitur edhe në DT.

Pretendimi i OE: Neni 27 — Dosja e tenderit

Eksperti shqyrtues ka analizuar dosjen e tenderit për kontratën në fjalë, dhe në bazë të vlerësimeve konstatojmë se ky pretendim i OE “International Security Association” SH.P.K është i pabazuar, për faktin se: Dosja e tenderit (DT) për kontratën në fjalë përfshinë informatat relevante që OE-të të interesuar duhet të dinë për përgatitjen e tenderëve të lidhura me procedurat e dhënies së kontratës, si: specifikimet, kërkesat, kriteret, afatet kohore, metodologjitë, kushtet e kontratës, afati për sqarimet e dosjes së tenderit, etj. Neni 27 i ligjit nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, autoriteti kontraktues do të përpilojë një dosje të tenderit që ofron informatat përkatëse lidhur me kontratën në fjalë, duke përfshirë të gjitha termat dhe kushtet materiale të saj, procedurat e zbatueshme të prokurimit,

çfarëdo kërkesë të aplikueshme të përshtatshmërisë ose ndonjë kriter të përzgjedhjes, procedurat e ankesës si dhe informatat e tjera përkatëse siç kërkohen nga ky ligj ose siç i sheh të domosdoshme autoriteti kontraktues. Autoriteti kontraktues duhet të përcaktojë në dosjen e tenderit, specifikimet teknike të zbatueshme dhe, aty ku është e përshtatshme, kërkesat ekzekutuese, mundësinë e varianteve dhe informatat lidhur me nën-kontraktimin në pajtim me nenet 28, 29, 30 dhe 31 të këtij ligji.

Pretendimi i OE: Neni 28 — Specifikimet teknike & Ligji i punës — 03/L-212

Eksperti shqyrtues pas shqyrtimit të dosjes së tenderit përkatësisht SPECIFIKAT teknike të detyrueshme dhe pretendimeve të OE, se përllogaritjet e specifikave të AK-së janë të paqarta dhe të gabuar sepse na detyrojnë të bëjmë shkelje ligjesh dhe udhëzimesh administrative të ligjit të punës për shkak të orarit të stër ngarkuar, pa pushim dhe mbi orët e lejuara, janë të pabazuar, për faktin se OE “International Security Association” SH.P.K, ka gabuar gjatë përllogaritjeve të numrit të punëtorëve në vendroje sepse ka supozuar se numri punëtorëve i përcaktuar nga AK në një vendroje, do të jetë fiks dhe me orar të plotë për gjatë 24 orëve, përderisa AK ka përcaktuar këtë numër duke llogaritur numrin e përgjithshëm të punëtorëve të nevojshëm për 24 orë duke respektuar orët/punë. Kërkesat specifike (Kushtet e Veçanta të Kontratës) Me këtë kontratë parashihet angazhimi i punëtorëve për sigurim fizik në objektet e Komunës së Gjakovës. Punëtorët e angazhuar me këtë kontratë do të punojnë 8 orë në ditë / 40 orë në javë (Në harmoni me ligjin e Punës LIGJI Nr. 03/L-212). Numri i punëtorëve që do të angazhohen me këtë kontratë do të jetë 34 punëtorë, me mundësi të shtimit edhe të punëtorëve të tjerë në rast nevojë (sipas kërkesës së menaxherit të Kontratës) Aneksi 1: Specifikimet teknike të detyrueshme;

Lokacioni	Numri i Punëtorëve	Orë	Ditë të javës	Gjithsejtë Orë
Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrative*	6	24	5	240
Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrative*	3	24	2	48
Biblioteka e Qytetit	4	24	7	224
Pallati i Rinis “Asim Vokshi”	4	24	7	168
Pallati i Sporteve Shani Nushi”	4	24	7	168
Shkolla e Muzikës “Prenk Jakova”	1	8	7	56
QKMF*	3	24	7	168
QPS	1	8	5	40
Përgjegjësitë Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	1	8	5	40
Drejtoria për Arsim, Shkencë dhe Teknologji	1	8	5	40
Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë	3	24	7	168
Këshilli i Vjetër	1	8	5	40
Pika Grumbulluese e Mjaltit në Brekoc	1	8	7	56
Impianti i Ujërave Të Zeza (Deri sa të bëhet dorëzim	1	8	7	56

pranimi i impiantit në KRU Gjakova)				
Numri i orëve në javë				1512
Numri i orëve të parashikuar për 2 vite apo 104 javë				157248

Me datë 30.11.2020, AK ka dhënë sqarime shtesë për OE, në lidhje me specifikat dhe angazhimin e punëtorëve/orëve, si në vijim: Drejtorinë për punë të përgjithshme administrative kemi kërkuar që: Gjate 5 ditëve të punës (E Hënë - E Premte) të jenë 6 punëtorë (nga 2 punëtorë në ndërrim * 3 ndërrime); Gjate 2 ditëve të fundjavës (E Shtune - E Diele) të jenë 3 punëtorë (nga 1 punëtorë në ndërrim 3 ndërrime) Pika Grumbulluese e Mjaltit në Brekoc: Gjate 7 ditëve të javës (E Hënë - E Diele) të jenë punëtorë (1 punëtor në ndërrim * 1 ndërrim) impianti i Ujerave të zeza: Gjate 7 ditëve të javës (E Hënë - E Diele) të jenë 1 punëtorë(1 punëtor në ndërrim * 1 ndërrim) Apo $240 \text{ orë} / 8 \text{ orë pune} = 30 \text{ orë} / 5 \text{ ditë} = 6 \text{ punëtor}$ Apo nëse do të ishte angazhuar vetëm nga një punëtor në një ndërrim, për 24 orë do të duhet të angazhohen 3 punëtorë. Çështjet e organizimit operacional, rregullimi i ndërrimeve të stafit, menaxhimi i orarit të punës, caktimi nëpër lokacione, pushimeve vjetore apo pushimeve të natyrave tjera, është përgjegjësi e OE. Duke u bazuar sqarimet e lartpërmendura konstatojmë se AK, ka përcaktuar qartë nevojat specifikuimet teknike që përshkruajnë dhe përkufizojnë, në mënyrë jo-diskriminuese, karakteristikat e obligueshme të objektit të kontratës. Neni 28 i ligjit nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikuimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikuime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik. UOP, pika 20.4 Specifikuimet /TER do të jetë e qartë, e saktë dhe precize dhe duhet të mos paraqet kufizime të panevojshme, në mënyrë që të mos kufizohet konkurrenca. Ato duhet të përkufizohen në mënyrë që mos të krijojnë dyshime rreth natyrës së mallrave, punëve ose shërbimeve të kërkuara.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues, që të REFUZOHET si e pabazuar ankesa e OE ankues, "International Security Association" SH.P.K, Prishtinë. Propozoj që të aprovohet vazhdimi i aktivitetit të prokurimit "SIGURIMI FIZIK I OBJEKTEVE TË KOMUNËS SË GJAKOVËS", me nr. të prokurimit 632-20-7505-2-1-1 si dhe nr. i brendshëm 632-20-119-211, i iniciuar nga AK – KOMUNA E GJAKOVËS, sipas dispozitave të LPP-së.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 28.12.2020 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti kontraktues me datë 29.12.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik "International Security Association" SH.P.K-Prishtinë me datë 29.12.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Te Nderuar Konfirmojmë marrjen e emailit dhe njëkohësisht ne nuk pajtohemi me mendimin e ekspertit shqyrtues, pasi që nuk është analizuar në tërësi ankesa jone nga eksperti shqyrtues.

Duke pas parasysh se AK ka caktuar numrin e punëtorëve për secilën pike, dhe numri I punëtorëve të caktuar është 34 punëtor pas përmirësimit të dosjes, numër ky I cili ka qene I caktuar me herët në dosjen e tenderit me 36 punëtor, dhe me pas është zbritur numri në 34, pas kërkesës për sqarim shtese nga ne si OE me interes në këtë aktivitet prokurimi. Pas kësaj nuk është vërejtur se kur caktohet numri I punëtorëve për një vendroje dhe orët e punës me orar 8 orësh në ditë atëherë si mundet që në disa vendroje të caktohet numri I punëtorëve me 4 punëtor 24 ore kurse në disa nga vendrojat 3 me 24 ore, kjo me logjik të thjeshtë është e gabuar, sepse në nuk mund të kryejmë shërbimet e sigurimit në vendrojat ku kërkohen 3 punëtor sigurimi për 24 ore pasi që në nuk mund të paguajmë një punëtor shtese duke pas parasysh se AK ka caktuar numrin e punëtorëve. Në momentin që AK ka kërkuar që të respektohet ligji I punës dhe të drejtat e dala nga ky ligj, atëherë ne jemi të obliguar që të respektojmë këtë kërkesë të tillë. Po ashtu duke pas parasysh se AK ka caktuar pagën minimale për punëtor sigurimi atëherë, për të mos thyer ligjin e punës në duhet të paguajmë 4 punëtor sigurimi të cilët do të punojnë në rrotacion me orar 8 orësh kurse AK në baze të tabelës së dhënë në ANEKS 1 të DT-se, evidenton vetëm 3 punëtor që duhet angazhuar dhe që do të paguhet për shërbime në vendroje 24/7 ditë.

Andaj ne nuk pajtohemi me mendimin e ekspertit shqyrtues dhe kërkojmë që të na jepet një sqarim se si do të paguhet punëtorët e sigurimit në baze të ligjit të punës së Republikës së Kosovës, dhe se çfarë shpjegimi jep prsh. për vendrojen

Pika Grumbulluese e Mjaltit në Brekoc	1	8	7	56
---------------------------------------	---	---	---	----

Ku kërkohet një punëtor të punoj në 7 ditë të javës me nga 8 ore pa pushim dhe nga AK pagesa do të bëhet vetëm për një punëtor sigurimi. Në tabelën e dhënë nga AK kemi edhe vendroje tjera të cilat janë të dhëna me të njëjtin numër dhe sasi orësh.

Lokacioni	Numri i	Orë	Ditë të	Gjithsejtë
-----------	---------	-----	---------	------------

	Punëtorëve		javës	Orë
Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrative	6	24	5	240
Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrative	3	24	2	48
Biblioteka e Qytetit	4	24	7	224
Pallati i Rinis "Asim Vokshi"	4	24	7	168
Pallati i Sporteve Shani Nushi"	4	24	7	168
Shkolla e Muzikës "Preng Jakova"	1	8	7	56
QKMF	3	24	7	168
QPS	1	8	5	40
Përgjegjësitë				
Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	1	8	5	40
Drejtoria për Arsim, Shkencë dhe Teknologji	1	8	5	40
Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë	3	24	7	168
Këshilli i Vjetër	1	8	5	40
Pika Grumbulluese e Mjaltit në Brekoc	1	8	7	56
Impianti i Ujërave Të Zeza (Deri sa të bëhet dorëzim pranimi i implantit në KRU Gjakova)	1	8	7	56
Numri i orëve në javë				1512
Numri i orëve të parashikuar për 2 vite apo 104 javë				157248

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 11.01.2021, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Pretendimi i OE ankues “International Security Association” SH.P.K-Prishtinë, se AK ka shkelur nenin 17 - llogaritja e vlerës se parashikuar të kontratës për shërbime, ku çmimi i ofertës pas llogaritjeve del të jetë 290,043.25 euro për dy vite, kurse buxheti i ndarë për ekzekutimin e kësaj kontrate është në vlerë prej 267,269.20 euro dhe që është minus 22,774.04 euro, pa llogaritur kërkesat tjera... Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të pretendimit ankimor, ekzaminimit të dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe specifikimet teknike të detyrueshme, konstaton se ky pretendim i OE “International Security Association” SH.P.K është i pabazuar për faktin se: Operatori ekonomik “International Security Association” SH.P.K, ka llogaritur gabimisht pagën bruto (284.49 euro) për punëtor. Ky gabim në kalkulim nga OE ankues është bërë pasi që AK ka kërkuar që paga neto të mos jetë nën 250 euro dhe nëse 250 euro i shtojmë tatimin dhe kontributet pensionale, rezulton si në vijim:

Paga BRUTO	Kontributi nga punëtori (5%)	Kontributi nga punëdhënësi (5%)	Gjithsej Kontributi	Paga që tatohet	Gjithsej tatimi	Paga NETO
270.94	13.55	13.55	27.10	257.39	7.39	250.00

Shënim: Të ardhura të tatueshme — Kur nga paga bruto zbriten kontributet pensionale, atëherë pjesës së mbetur i referohemi si “të ardhura të tatueshme”. Pra, nga shuma e pagës bruto, fillimisht zbritet Kontributi Pensional i të punësuarit dhe më pastaj shuma e mbetur tatohet. Tatimi i pagës prej 0 - 80 = 0.00 € Tatimi i pagës prej 80 - 250 = 6.80 € Tatimi i pagës prej 250-450 = 0.59 € Gjithsej tatimi i pagës = 7.39 €. Po ashtu kjo mund të vërtetohet edhe në kalkulatorin e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), të cilin mund të gjeni në ueb faqen e ATK-së, në linkun në vijim: <http://ëëë.atk-ks.org/kalkulatori-i-pagave-nga-neto-ne-bruto/>.

Sa i përket kalkulimit nga ana e OE ankues, i njëjti ka llogaritur 36 punëtorë që duhet angazhuar në këtë aktivitet të prokurimit përderisa në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për informata shtesë ose përmirësim i gabimit (Formulari B54), nga AK, është përcaktuar/njoftuar që numri i punëtorëve që do të angazhohen me këtë kontratë do të jetë 34 punëtorë.

Me këtë kontratë parashihet angazhimi i punëtorëve për sigurim fizik në objektet e Komunës së Gjakovës. Punëtorët e angazhuar me këtë kontratë do të punojnë 8 orë në ditë / 40 orë në javë (Në harmoni me ligjin e Punës LIGJI Nr. 03/L-212). Numri i punëtorëve që do të angazhohen me këtë kontratë do të jetë 34 punëtorë, me mundësi të shtimit edhe të punëtorëve të tjerë në rast nevojë (sipas kërkesës së menaxherit të Kontratës). Duke u nisur nga kjo, vërtetohet se buxheti i planifikuar është:

Numri i punëtorëve	Paga bruto	Shuma e pagave për muaj	Afati i paraparë i kontratës	Total buxheti për punëtorët e angazhuar	Total buxheti me taksat tjera TVSH	Vlera e parashikuar e kontratës
34	70.94	9,211.96	24 muaj	221,087.04	260,882.71	267,269.20

Kalkulimet tregojnë se buxheti i planifikuar është brenda vlerës së parashikuar të kontratës nga AK. Meqenëse njoftimi për kontratë/dosja e tenderit ka për qëllim dhënien e një kontrate publike kornizë, AK-së i lejohet një devijim deri në 30% +/-, e cila është paraqitur edhe në DT.

Pretendimi tjetër i OE ankues "International Security Association" SH.P.K-Prishtinë, që ka të bëjë me nenin 27 - dosja e tenderit, Paneli Shqyrtues pas analizimit të dosjes së tenderit për kontratën në fjalë dhe në bazë të vlerësimeve, sqaron se dosja e tenderit për kontratën në fjalë përfshinë informatat relevante që OE-të të interesuar duhet të dinë për përgatitjen e tenderëve të lidhura me procedurat e dhënies së kontratës, si: specifikimet, kërkesat, kriteret, afatet kohore, metodologjitë, kushtet e kontratës, afati për sqarimet e dosjes së tenderit, etj. Sepse, neni 27 i LPP-së ka përcaktuar se autoriteti kontraktues do të përpilojë një dosje të tenderit që ofron informatat përkatëse lidhur me kontratën në fjalë, duke përfshirë të gjitha termat dhe kushtet materiale të saj, procedurat e zbatueshme të prokurimit, çfarëdo kërkesë të aplikueshme të përshtatshmërisë ose ndonjë kriter të përzgjedhjes, procedurat e ankesës si dhe informatat e tjera përkatëse siç kërkohen nga ky ligj ose siç i sheh të domosdoshme autoriteti kontraktues. Autoriteti kontraktues duhet të përcaktojë në dosjen e tenderit, specifikimet teknike të zbatueshme dhe, aty ku është e përshtatshme, kërkesat ekzekutuese, mundësinë e varianteve dhe informatat lidhur me nën-kontraktimin në pajtim me nenet 28, 29, 30 dhe 31 të këtij ligji.

Pretendimi i OE ankues se AK ka shkelur nenin 28 - specifikimet teknike dhe Ligji i Punës Nr. 03/L-212, se përlllogaritjet e specifikave të AK-së janë të paqarta dhe të gabuara sepse na detyrojnë të bëjmë shkelje ligjesh dhe udhëzimesh administrative të ligjit të punës për shkak të orarit të stërngarkuar, pa pushim dhe mbi orët e lejuara, Paneli Shqyrtues sqaron se AK ka përcaktuar numrin e punëtorëve duke llogaritur numrin e përgjithshëm të punëtorëve të nevojshëm për 24 orë duke respektuar orët/punë. Kërkesat specifike (Kushtet e Veçanta të Kontratës). Punëtorët e angazhuar me këtë kontratë do të punojnë 8 orë në ditë / 40 orë në javë (Në harmoni me ligjin e Punës LIGJI Nr. 03/L-212). Numri i punëtorëve që do të angazhohen me këtë kontratë do të jetë 34 punëtorë, me mundësi të shtimit edhe të punëtorëve të tjerë në rast nevojë (sipas kërkesës së menaxherit të Kontratës) Aneksi 1: Specifikimet teknike të detyrueshme;

Lokacioni	Numri i Punëtorëve	Orë	Ditë të javës	Gjithsejtë Orë
-----------	--------------------	-----	---------------	----------------

Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrative*	6	24	5	240
Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrative*	3	24	2	48
Biblioteka e Qytetit	4	24	7	224
Pallati i Rinis "Asim Vokshi"	4	24	7	168
Pallati i Sporteve Shani Nushi"	4	24	7	168
Shkolla e Muzikës "Preng Jakova"	1	8	7	56
QKMF*	3	24	7	168
QPS	1	8	5	40
Përgjegjësitë				
Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	1	8	5	40
Drejtoria për Arsim, Shkencë dhe Teknologji	1	8	5	40
Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë	3	24	7	168
Këshilli i Vjetër	1	8	5	40
Pika Grumbulluese e Mjaltit në Brekoc	1	8	7	56
Impianti i Ujerave Të Zeza (Deri sa të bëhet dorëzim pranimi i impiantit në KRU Gjakova)	1	8	7	56
Numri i orëve në javë				1512
Numri i orëve të parashikuar për 2 vite apo 104 javë				157248

Po ashtu, me datë 30.11.2020, AK ka dhënë sqarime shtesë për OE në lidhje me specifikat dhe angazhimin e punëtorëve/orëve, si në vijim: Drejtorinë për punë të përgjithshme administrative kemi kërkuar që: Gjatë 5 ditëve të punës (E Hëne - E Premte) të jenë 6 punëtorë (nga 2 punëtorë në ndërrim * 3 ndërrime); Gjatë 2 ditëve të fundjavës (E Shtune - E Diele) të jene 3 punëtorë (nga 1 punëtorë në ndërrim 3 ndërrime), Pika Grumbulluese e Mjaltit në Brekoc: Gjatë 7 ditëve të javës (E Hëne - E Diele) të jenë punëtorë (1 punëtor në ndërrim * 1 ndërrim) impianti i Ujerave të zeza: Gjatë 7 ditëve të javës (E Hëne - E Diele) të jene 1 punëtorë(1 punëtor në ndërrim * 1 ndërrim) Apo 240 orë / 8 orë pune = 30 orë / 5 ditë = 6 punëtor. Apo nëse do të ishte angazhuar vetëm nga një punëtor në një ndërrim, për 24 orë do të duhet të angazhohen 3 punëtorë. Çështjet e organizimit operacional, rregullimi i ndërrimeve të stafit, menaxhimi i orarit të punës, caktimi nëpër lokacione, pushimeve vjetore apo pushimeve të natyrave tjera, është përgjegjësi e OE.

Duke u bazuar sqarimet e lartpërmendura, AK ka përcaktuar qartë nevojat specifikimet teknike që përshkruajnë dhe përkufizojnë, në mënyrë jo-diskriminuese, karakteristikat e obligueshme të objektit të kontratës. Neni 28 i LPP-së ka përcaktuar që autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik. UOP, pika 20.4 Specifikimet /TER do të jetë e qartë, e saktë dhe precize dhe duhet të

mos paraqet kufizime të panevojshme, në mënyrë që të mos kufizohet konkurrenca. Ato duhet të përkufizohen në mënyrë që mos të krijojnë dyshime rreth natyrës së mallrave, punëve ose shërbimeve të kërkuara.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, sqaron se autoriteti kontraktues ka përpiluar dosjen e tenderit duke përfshirë edhe specifikimet teknike në bazë të nenit 27 dhe 28 të LPP-së. Andaj, i lejohet autoritetit kontraktues që të vazhdoj me këtë aktivitet të prokurimit.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK "KK-Gjakovë";
- 1x1 OE "International Security Association" SH.P.K-Prishtinë;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.